VENDIM
Nr. 211, datë 15.12.2020

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "*ENERGIJA DOO VETERNIK*" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "e"; të nenit 5, pika 1, germa "e"; të nenit 10, pika 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "*Energija Doo Veternik*" sh.p.k., si dhe relacionin nr. 132/1 prot., datë 10.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "*Energija DOO Veternik*" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "*Energija DOO Veternik*" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1086/2 prot., datë 26.10.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Në datën 6.01.2015 është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

- Aplikimi i shoqërisë "*Energija DOO Veternik*" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c") është plotësuar tërësisht;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d" "e", "f" dhe "g") është plotësuar pjesërisht;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8; germat: "a", "b", "c", "d") është plotësuar pjesërisht;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8, germat: "a", "b", "c"), është plotësuar pjesërisht.

- Në mbledhjen e Bordit të ERE-s, të datës 2.12.2020, në vijim të relatimit të relacionit nr. 125/2 prot., datë 1.12.2020, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "'*Energija DOO Veternik*' në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike" dhe relacionit nr. 125/3 prot., datë 1.12.2020, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë '*Energija DOO Veternik'* në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike", Bordi gjykoi që vendimi i fillimit të procedurave për këto aplikime të shtyhej, në mënyrë që shoqëria të kryejë diferencën e pagesës së aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, duke qenë se rezultoi që kjo pagesë nuk ishte kryer e plotë.

- Në vijim të sa me sipër, ERE iu drejtua shoqërisë me *email*-in e datës 2.12.2020, protokolluar në po të njëjtën datë me nr. 1086/3 prot., duke i bërë me dije se në kuptim të nenit 8, pika 2 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", aplikuesi do të kryej pagesën e aplikimit në momentin e paraqitjes së aplikimit, siç përcaktohet në aneksin A të saj. Po në kuptim të këtij neni një aplikim duhet të jetë i shoqëruar me pagesën e aplikimit e më tej të vijohet me trajtimin e tij. Po ashtu iu kërkua shoqërisë kryeja e pagesave respektive në llogarinë e ERE-s me qëllim trajtimin e kërkesës për licencim në mbledhjen më të afërt të Bordit të ERE-s, dhe iu shpjegua se kryerja e pagesës së aplikimit përbën një nga kushtet thelbësore për fillimin e një procedure.

- Shoqërisë i janë dhënë edhe më herët sqarimet përkatëse për aplikimin e ri për licencim me *email*-in e datës 26.10.2020.

- Nga rakordimi me Drejtorinë e Financës dhe IT nuk rezulton që deri më sot shoqëria të ketë kryer pagesat respektive, si më sipër kërkuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "*Energjia DOO Veternik*" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti